

10.04.2021

Ora 11:57

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, E.Meta |
| • Parti | Politike: | LSI |

Znj. I.Nano: Mirëdita, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Rendi i ditës dhe materialet e mbledhjes i janë dërguar subjekteve zgjedhore, medias dhe të interesuarve. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. Është i pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të Administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kemi përfaqësues të subjekteve zgjedhore. Kemi dhe përfaqësues të OSBE/ODIHR. Në mbledhjen e sotme në rendin e ditës kemi shqyrtimin e një projektvendimi “Për organizimin e punës në vendin e numërimit votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të

1

Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Para se të filloj me shqyrtimin e aktit për procedurë do t’iu drejtohesha kolegeve dhe më tej përfaqësueseve të subjekteve zgjedhore nëse kanë diçka për të diskutuar jashtë rendit të ditës, kolegë?

Znj. H.Vukaj: Kam diçka jashtë rendit të ditës në fakt zonja Nano. Por, ta diskutojmë paraprakisht apo në fund?

Znj. I.Nano: Në fund. Mendoj mbasi të mbarojmë shqyrtimin e aktit mund të diskutoni.

Znj. H.Vukaj: Po, faleminderit.

Znj. I.Nano: Përfaqësuesit.. po zoti Çakaj.

Z. M.Çakaj: Edhe unë kisha diçka jashtë rendit të ditës, por mbasi të përfundoj, faleminderit.

Znj. I.Nano: Po, mbasi të shqyrtojmë aktin. Përfaqësues të subjekteve zgjedhore kanë diçka jashtë rendit të ditës?

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi asgjë.

Znj. I.Nano: Faleminderit. Atëherë, të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës unë kërkoj mirëkuptimi tuaj dhe miratimin tuaj njëkohësisht të nderuar kolegë që për shkak se akti është voluminoz, është i gjatë dhe ndërkohë pjesëmarrësit në mbledhje janë njohur me përmbajtjen e projektaktit do të doja të lexoja vetëm titujt e akteve pa lexuar përmbajtjen.. titujt e neneve pa lexuar përmbajtjen e secilit

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

nen dhe sigurisht nëse do të ketë diskutime në secilin nen, propozime për shtesa apo ndryshime sigurisht që do t'i trajtojmë. Jemi dakord me këtë mënyrë të shqyrtimit të aktit? Dakord, faleminderit. Atëherë, siç përmenda më herët akti vjen me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Është propozuar, është hartuar, punuar nga Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Do t'i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Merkaj të bënte prezantimin e projektaktit dhe më tej të fillojmë shqyrtimin e tij. Zoti Merkaj, ju lutem ta prezantoni aktin dhe relacionin bashkëlidhur, faleminderit.

Z.Y.Merkaj: Atëherë, përshëndetje. Referuar nenit 20 të Kodit Zgjedhor është parashikuar kompetenca e Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, të referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Referuar nenit 12, paragrafi 4 i Kodit Zgjedhor Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Në zbatim të dispozitave të mësipërme që përcaktojnë kompetencën e Komisionit Rregullator është hartuar dhe projektvendimi i mësipërm. Ky projektvendim hartohet në kuadër të risive që solli Kodi Zgjedhor për mënyrën e prezantimit përpara zgjedhësve të koalicioneve zgjedhore dhe kandidatëve të listave shumëëmërore të subjekteve zgjedhore. Ndryshimet e fundit të kushtetuese dhe ligjore paraqitur para zgjedhësve shqiptar mundësin e votimit parapëlqyes për kandidatët e listave shumëëmërore të subjekteve zgjedhore dhe qasjet e subjekteve zgjedhore me listat shumëëmërore. Nenet 65, 67, 98, 106 dhe 118 të Kodit Zgjedhor parashikojnë mënyrën e votimit dhe vlerësimin e votave parapëlqyese për kandidatin për deputet si dhe përbërjen e koalicioneve zgjedhore. Këto ndryshime bëjnë të pazbatueshëm udhëzimin nr.5 të vitit 2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve prandaj për të mundësuar vendosjen e rregullave dhe rradhën e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*


veprimeve nevojitet hartimit i një akti të ri i cili trajton ndryshimet e reja ligjore. Qëllimi i këtij projektvendimi është detajimi i rregullave për mënyrën e organizimit të punës, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore nga komisioni i qendrës së votimit në vendin e numërtim të votave, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-ve si dhe anëtarët e grupit të numërimit gjatë procesit të numërimit të votave në nxjerrjen e rezultatit zgjedhor për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e listave shumëemërore. Projektakti përmban 5 krer dhe 28 nene.

Në KREU I të këtij projektvendimi përcaktohen qëllimet, detyrat e grupit të numërimit të votave si dhe përdorimi i teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.

KREU II rregullon veprimtarin e marrjes në dorëzim të materiale zgjedhore nga KZAZ-ja duke parashikuar përcaktimin e grupeve të marrjes në dorëzim si dhe rregullat kur një kuti deklarohet kuti e parregullt.

KREU III parashikon detyrat për procesin e numërimit të votave si dhe parashikon kushtet apo kriteret e prezencës së personave të autorizuar në vendin e numërimit të votave, veprimet paraprake të KZAZ-së, fillim e procesit të numërimit, rradhën e numërimit të votave si dhe rregullin për rradhën e numërimit të kutive.

KREU IV përcakton procedurat që ndiqen nga grupi i numërimit duke filluar me sistemin e kutive, procesin e numërimit të votave dhe procedurën që e pason atë, rastet kur hapet kutia e materialeve të votimit dhe rradha e veprimeve të grupit të numërimit të votave, llojet e votave, kriteret e vlerësimit të votave. Gjithashtu, është parashikuar procedura për kontestimin dhe rivlerësimin e votës, numërimi i votave si në çdo rast si subjekteve zgjedhore, nxjerrjes së datës për subjekte zgjedhore nga grupet e numërimit, mbylljen e kutisë me fletët e votimit dhe nxjerrjen e tabelës së rezultateve për subjektet zgjedhore. Gjithashtu,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

parashikohet numërimi i votave për kandidatët e listave shumëëmërore dhe koalicioneve si dhe nxjerrjes së rezultatit të tyre.

Në KREU V trajtohet ankimi dhe hyrja në fuqi e këtij projektvendimi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Merkaj për prezantimin e detajuar të projektaktit. Atëherë, fillojmë shqyrtimin e projektaktit sipas rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator faza e parë është diskutimi dhe më pas votimi në parim i projektaktit. Në këtë fazë fjala iu takon së pari anëtarëve të Komisionit Rregullator, më pas përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Të nderuar kolegë keni diçka për të diskutuar në parim lidhur me projektaktin? Po zonja Vukaj.

Znj.H.Vukaj: Faleminderit zonja Nano. Në parim akti është.. konsiderohet një akt jo i jashtëzakonshëm, por shumë i rëndësishëm pasi është jetik për procesin. Ky diskutim i imi në parim vjen vetëm për të fokusuar apo për t'u ndalur në një nga risit e Kodit me këtë rast, i cili vërtet implementon apo fut votën parapëlqyese. Por, nga ana tjetër Kodi i jep mundësin subjekteve ashtu si edhe kandidatëve të kenë mundësin e ankimit të shtuar dhe njëkohësisht edhe të hallkave të ankimit siç është KAS apo të verifikimit të jashtëm të aktit më tej në gjykatë, faleminderit zonja Nano.

Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj. Gjithashtu, doja të theksoja rëndësin e aktit pas gjithë procesi parapërgatitor për zgjedhjet, i cili tashmë është normuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve qoftë nga Komisioni Rregullator, qoftë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në fund të fundit ka për qellim realizimin e një votimi të drejtë. Një proces i votimit të drejtë, por edhe një proces i numërimit të drejtë dhe të rregullt. Kështu që me këtë akt rregullojmë mënyrën se si

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

organizohet puna në vendet e numërimit të votave. Cilat janë gjithë veprimet hap pas hapi që ndërmerren nga dorëzimi i materialeve zgjedhore, numërimi dhe deri në nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve. Në këtë kuptim konsiderohet një akt me karakter procedural, por jashtëzakonisht i rëndësishëm për të mbyllur me sukses le të themi procesin e numërimit të votave. Një proces vendimtarë po themi në nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve. Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera unë do të ftoja kolegët që të votojmë në parim projektaktin.

Kush është dakord në parim me projektaktin, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet projektakti në parim!

Fillojmë shqyrtimin nen për nen.

KREU I – Të përgjithshme. Neni 1 – Qëllimi.

Do të ftoja.. me sa shohë kemi vetëm përfaqësuesin e një subjekti zgjedhor, zoti Kaziaj përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim. Duke qenë se janë një sërë nenesh unë do të kërkoja nga ju nëse do të keni diçka për një nen të veçantë ju lutem të kërkonit fjalën.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Patjetër.

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Kaziaj. Atëherë, neni 1 – Qëllimi, kemi ndonjë diskutim apo propozim për shtesa, ndryshime? Nëse jo kalojmë në votimin e nenit 1 sipas përmbajtjes së propozuar.

Kush është dakord me nenin 1 - Qëllimi?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 1!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Kalojmë në nenin 2 – Detyrat e grupit të numërimit të votave. Diskutime, propozime nuk shoh. Kalojmë në votimit e nenit 2.

Kush është dakord me nenin 2, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 2!

Neni 3 – Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave. Në këtë rast sigurisht që bëhet fjalë për kamerat që instalohen në çdo vend numërimi të votave dhe çdo tavolinë të numërimit. Nëse nuk kemi komente ju ftoj të votojmë nenin 3 – Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave.

Kush është dakord me nenin 3?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 3!

KREU II – Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ-ja. Neni 4 – Caktimi i grupeve të marrjes në dorëzim. Komente, propozime? Nëse jo kalojmë në votimin e nenit 4 - Caktimi i grupeve të marrjes në dorëzim.

Kush është dakord me nenin 4?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 4!

Neni 5 – Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim. Kemi komente, propozime? Jo, atëherë votojmë nenin 5 sipas përmbajtjes së propozuar.

Kush është dakord me nenin 5?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 5!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Neni 6 – Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor. Është një nen në fakt i gjatë, i rëndësishëm që lidhet me të gjitha. Përshkruan të gjitha hapat e procesit të marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor nga KZAZ-ja. Nëse nuk ka komente ju ftoj të votojmë nenin 6.

Kush është dakord me nenin 6?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 6!

Neni 7 – Kutitë e deklaruara “kuti e parregullt”. Kemi ndonjë koment, ndonjë.. po zoti Çela.

Z.A.Çela: Faleminderit, kam një propozim për të hequr tek pika 1, “b” fjalën “janë” pasi bëhet fjalë vetëm për një kuti votimi në zgjedhjet për Kuvend. Nuk janë dy si në zgjedhjet lokale. Propozoj që të hiqet fjala “janë”, faleminderit.

Znj.I.Nano: Dakord, ka propozim tjetër për këtë nen, neni7? Deri tani kemi vetëm një propozim për ndryshim pra, për heqje e fjalës “janë” në fjalinë e parë të germës “b” të pikës 1 të nenit 7. Me argumentin që në zgjedhjet për Kuvend kemi vetëm një kuti votimi. Kolegë votojmë, ju lutem propozimin e zotit Çela.

Kush është dakord me prpozimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Z.M.Çakaj: Dakord.

Znj.I.Nano: Ju lutem, gjatë zbardhjes të kihet parasysh ky ndryshim. Neni 8 – Sistemimi i kutive me fletët e votimit dhe kutit me materialet e votimit në VNV. Ka ndonjë koment, ndonjë diskutim? Nëse jo votojmë nenin 8, ju lutem.

Kush është dakord me nenin 8?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 8!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Znj. Iliriana Nano:

Kreu III.

Fillimi i procesit të numërimit!

Neni 9.

Personat e pranishëm në vendin e numërimit të votave.

Kemi ndonjë koment?! Ndonjë propozim për shtesë apo ndryshim?!

Dakord! Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e nenit 9.

Kush është dakord me nenin 9 ashtu siç është propozuar?!

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 10.

Veprime paraprake të KZAZ-së.

Ka ndonjë propozim apo ndonjë koment për neni 10 ju lutem?!

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e nenit 10!

Kush është dakord me nenin 10 siç është propozuar nga Komisioneri?!

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 11.

Fillimi i procesit të numërimit të votave.

Nuk ka komente. Kalojmë në votimin e nenit 11!

Kush është dakord me nenin 11?!

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 12.

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Radha e numërimit në zgjedhjet në kuvend. Dhe këtu në fakt është pasqyruar ajo çfarë dhe kodi zgjedhor parashikon; dy fazat e numërimit; faza e parë për subjektet zgjedhore për të gjitha QV-të dhe faza e dytë për numërimin e votave të kandidatëve të listave shumë emërore të partive dhe kandidatëve të koalicioneve zgjedhore.

Kemi ndonjë koment apo ndonjë propozim për shtesë apo ndryshim në këtë nen?! Jo! Atëherë, ju ftoj të votojmë nenin 12. Radha e numërimit në zgjedhjet në kuvend.

Kush është dakord me nenin 12?!

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Kalojmë në Kreun IV.

Procedurat që ndiqen për numërimin e votave nga grupi i numërimit të votave.

Neni 13.

Veprime paraprake të GNV-së.

Kolegë, nëse ka komente?! Unë personalisht kam një propozim për një shtesë! Në fakt ne kemi miratuar një akt pararendës për organizimin e vendeve të numërimit të votave, duke parashikuar në detaje, me hollësi gjithë materialet që përdoren në vendet e numërimit të votave. Dhe, duke qenë një proces delikat ai i numërimit, ku duhet që kutitë të kalojnë njëra pas tjetrës, ku të ekspozohen kutitë por edhe fletët e votimit në kamera, ajo çka është e rëndësishme, është se ne kemi thënë që kamerat të fokusojnë numrin e kutisë së votimit, por, për ta bërë më të qartë këtë për vëzhguesit por edhe për ata që do të ndjekin numërimin në kohë reale, propozoj që të shtohet pas shkronjës “a” një shkronjë “b” ku të parashikohet mundësia që në vendin, që është përcaktuar më herët nga KZAZ-ja, të vendoset një etiketë adezive ku të shënohet numri i qendrës që po numërohet. Dhe, mendoj, t’ia ngarkojmë këtë përgjegjësi sekretarit të GNV-së, pra, grupit të numërimit të votave.

***Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Pra, sekretari i GNV-së ngjit në tavolinë, në vendin e përcaktuar nga KZAZ-ja, etiketën adezive ku është shkruar numri i qendrës së votimit që numërohet, ose të shkruajë në numrin e qendrës së votimit, sepse për secilin rast do të duhet të vendoset një etiketë e radhës.

Nga administrata ka një koment?!

Zoti Ylli Merkaj: Kam përshtypjen se duhet të jetë në një nen më poshtë, është në momentin që fillojnë, ... pra, vendoset të hapet kutia dhe fillojnë numërimin e fletëve të votimit, sepse ajo bëhet për çdo qendër votimi.

Ideja është që do të merret kutia me fletët e votimit; do të vendoset mbi tavolinën e grupit të numërimit; dhe pasi hapet, para se të vendosen fletët e votimit për tu numëruar, duhet të vendoset adezivi tek kjo qendër numërimi, dhe pastaj do të vendoset një qendër tjetër, ...

Znj. Iliriana Nano: Po jemi tek neni 13, pika a, dhe pikërisht mbas pikës “a” unë propozoj të shtohet kjo; pastaj kam edhe një propozim tjetër për nenin 14 lidhur me këtë gjë;

Pra tek “Veprime paraprake”, a-ja thotë: nën kujdesin e një anëtari të ngarkuar nga KZAZ-ja, sekretari merr me radhë, sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit vetëm të një qendre dhe e vendos atë pranë tavolinës të një grupi numërimi. Në këtë moment vendos, ...

Zoti Ylli Merkaj: Ndoshta duhet të shënojmë që duhet të bëhet për çdo qendër votimi.

Znj. Iliriana Nano: Për çdo qendër, po, po për çdo qendër votimi; Pasi e merr kutinë e votimit vendos në një mënyrë që të jetë e ekspozuar në një letër që ngjitet, pra, vendoset në tavolinën e numërimit.

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Atëherë, nëse nuk ka propozim tjetër, votojmë propozimin që pas pikës a të shtohet pika b me përmbajte sikundër unë e propozova më sipër, kolegë?!

Kush është dakord?!

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Pra, neni 13 pika 1, tashmë është me tre germa, a, b, dhe c.

Neni 14.

Numërimi i votave.

Po hap diskutimin, ndërkohë unë vetë kam një propozim, që, përveç asaj që u propozua dhe u miratua më sipër për vendosjen e letrës adezive, mendoj “të ekspozohet kutia e votimit në kamera, faqja që është e shkruar qendra e votimit, por jo më shumë se dy sekonda dhe pastaj të vijohet me procesin”. Pra që të identifikohet në çdo rast edhe nëpërmjet kamerave dhe të monitorohet se cila është qendra e votimit që po numërohet.

Pra, numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë e votimit, me fletët e votimit dhe ekspozon në kamera për rreth dy sekonda faqen anësore, ku është vendosur etiketa me numrin e qendrës së votimit, pastaj të vijë pjesa për hapjen e kutisë duke këputur vulat e sigurisë.

Kolegë nuk e di nëse isha e qartë me këtë propozim?!

Kemi komente ose propozime të tjera?!

Faleminderit!

Atëherë po votojmë propozimin për të shtuar këtë pjesë të fjalisë në pikën 1 të nenit 14.

Kush është dakord, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Kalojmë tek neni 15.

Rastet kur hapet kutia e materialeve të votimit.

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Kemi ndonjë diskutim qoftë nga subjektet zgjedhore, qoftë nga kolegët lidhur me këtë çështje?!

Nuk ka! Atëherë, ftoj për votim kolegët!

Votojmë për nenin 15, ju lutem!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Neni 16.

Hapja e kutisë së materialeve të votimit, procedura dhe rradha e veprimeve të GNV-së.

Ka ndonjë koment, ndonjë diskutim apo propozim?!

Nëse jo, atëherë votojmë nenin 16!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Kalojmë të neni 17!

Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës.

Kemi ndonjë koment, ndonjë diskutim, ju lutem!

Ka diçka për nenin 17 ju lutem?!

Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 17 sipas përmbajtjes së propozuar!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Neni 18.

Vlerësimi i votave. Dhe jemi në atë fazë që do ta quaja vlerësimi paraprak i votave pa kaluar në numërimin për subjektet zgjedhore.

Unë kam një propozim! Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë propozim tjetër.

Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Nuk e di nëse mundem të paraqes përpara jush propozimin tim dhe argumentin lidhur me të.

Në pikën 8 të nenit 18 është parashikuar: grupi i numërimit për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit për subjektin zgjedhor ose për një nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të subjektit zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor. Duke pasur parasysh që kemi dy faza numërimi, fazën e parë për subjektet dhe fazën e dytë për kandidatët e subjekteve të listave shumë emërore, propozimi im është që në këtë fazë të vlerësimit të votave, pra pa filluar numërimin, të kemi një ndarje mes fletëve të votimit ku është votuar qartësisht vetëm për subjektin zgjedhor; pra, për lehtësi procedurale të fazës së dytë, propozimi im është ky: mbasi mbaron fjalia e parë, e paragrafit 8 të nenit 18, propozoj të shtohet si me poshtë:

“Fletët e votimit në të cilat është votuar qartësisht, vetëm për subjektin zgjedhor, në përfundim të numërimit vendosen në një zarf të veçantë, i cili pas përfundimit të procesit të numërimit të votave futet në zarfin e subjektit zgjedhor. Për këtë rast mbahet një procesverbal sipas modelit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve”. Po zonja Vukaj!

Zonja Helga Vukaj: E gjej me vend të sqaroj në parim që ndërhyrja juaj është jo vetëm sistematike por edhe sistemuese, e nga ana tjetër do të rrisë integritetin e procesit, pra e mirëpres personalisht këtë ndërhyrje që ju bëtë, por do doja një qartësim ndoshta edhe për publikun dhe për ne këtu në këtë tryeze; e kam fjalën për zarfin i cili veçohet paraprakisht dhe vendosej në zarfin e madh të subjektit. Kështu?!

Znj. Iliriana Nano: Po!

Zonja Helga Vukaj: Dakord! Sepse ndoshta në fjali nuk u kuptua.

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Znj. Iliriana Nano: Pra, është një zarf i veçantë i cili në përfundim të procesit të numërimit të votave futet në zarfin me votat e subjektit zgjedhor.

Zonja Helga Vukaj: Pra është zarf i veçuar!

Znj. Iliriana Nano: Është një zarf i veçuar ku janë vetëm votat ku është votuar qartësisht vetëm për subjektin zgjedhor, zarf i cili nëse e shihni me vend ta plotësojmë në këtë moment apo në një moment të dytë nuk hapet në procesin e numërimit të votave për kandidatët e listave shumë emërore. E gjeni me vend ta vendosim këtu edhe faktin që ky nuk hapet. Atëherë, po shtoj edhe fjalinë tjetër: “Ky zarf nuk hapet apo nuk merret për tu rivlerësuar gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatet e listës shumë emërore”. Zoti Kaziaj, po!

Zoti Altin Kaziaj: Po gjatë kohës së rinumërimit, të themi, të atyre votave që janë për kandidatët e listave shumë emërore, ku do të ruhet ky zarf?!

Znj. Iliriana Nano: Atëherë është në tavolinën e, .. bëhet fjalë për ndarjen e fletëve në tavolinën e numërimit dhe unë them në përfundim të procesit të numërimit të votave futet tek zarfi i partive, tek zarfi i subjekteve zgjedhore.

Zoti Altin Kaziaj: Po gjatë kohës, ... se nuk mund të rrijë mbi tavolinën e numërimit besoj, duhet të futet në kutinë përkatëse të votimit.

Znj. Iliriana Nano: Nuk mund të vendoset në kuti në atë moment!

Zoti Merkaj, si Sekretar i Përgjithshëm donte për të sqaruar diçka.

Po, zoti Merkaj!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Z. Y.Merkaj: Atëherë, hapet kutia e votimit, numërohen për subjektet, vendosen nëpër zarfe, siç tha kryetarja, futen tek kutia dhe mbyllen prapë dhe rihapen prapë në një moment të dytë.

Znj. I.Nano: Pra, gjatë fazës të vlerësimit të votave, pa u numëruar, vlerësohen vota për subjektin, pastaj vota të pavlefshme, vota të kondestuara dhe tek ato që janë vota për "x" subjekt zgjedhor, dallojmë ato që janë qartësisht vetëm për subjektin, ndër votat e vlefshme vetëm për subjektin. Ato futen në një zarf të veçantë që më tej nuk rihapen dhe pastaj futen në kuti të gjitha, patjetër. Kështu që do t'i lutesha administratës, në momentin që do të dalë momenti i vendosjes në kuti të zarfeve ta rikujtojmë këtë moment nëse ka nevojë për të shtuar. Zoti Çakaj!

Z. M.Çakaj: Gjithashtu, besoj kjo duhet të evidentohet, dhe në një proces verbal, i cili normalisht do të miratohet nga Komisioneri.

Znj. I.Nano: Pra, për këtë rast mbahet një procesverbal sipas modelit të miratuar nga Komisioneri. Pra do kemi një procesverbal më vete.

Znj. H.Vukaj: I cili do identifikojë numrin e fletëve që u futën apo zarfeve.

Znj. I.Nano: Është një model që e miraton Komisioneri në raport dhe me modelet e tjera.

Znj. H.Vukaj: Është thjesht për anën sasiore dhe për transparencë.

Znj. I.Nano: Atëherë, ta rilexoj propozimin tim? Propozimi është, pas fjalisë së parë të pikës 8, të nenit 18, të shtohet: Fletët e votimit në të cilat është votuar qartësisht, vetëm për subjektin zgjedhor në përfundim të numërimit vendosen në

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

një zarf të veçantë, i cili pas përfundimit të procesit të vlerësimit të votave futet në zarfin me votat e subjektit zgjedhor. Për këtë rast mbahet një procesverbal i veçantë sipas modelit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

E votojmë ju lutem këtë propozim? Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet propozimi!

Për nenin 18 nuk kishim propozime të tjera, apo jo? Neni 19. Kontestimi dhe rivlerësimi i votës. Ka ndonjë koment, jo? Propozime për shtesa, ndryshime, jo!

Atëherë kalojmë në votimin e nenit 19, kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet neni 19!

Neni 20. Numërimi i votave të çdo subjekti zgjedhor. Ka ndonjë propozim, koment, pyetje? Kalojmë në votimin e nenit 20.

Kush është dakord me nenin 20?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 21. Nxjerrja e rezultateve të zgjedhjeve për subjektet zgjedhore nga grupi i numërimit. Ka ndonjë koment, zoti Çaka?

Z. D.Çaka: Sipas këtij neni do të normohet nxjerrja e rezultatit për subjektet zgjedhore. Ne si Komision Rregullator në pararendje të këtij akti, kemi miratuar dhe një akt të mëparshëm, që është vendimi nr.3, datë 09.02.2021 për kriteret e caktimit dhe të organizimit të vendit të numërimit të votave dhe një ndër pikat që ne kemi përcaktuar, jo vetëm tek skema, por njëkohësisht dhe në trupin e këtij akti, është që pranë VNV-së duhet të jetë një vend i veçantë, në të cilin sekretari të afishojë çdo tabelë përmbledhëse mbasi grupi i numërimit të votave do ta

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

përpilojë atë. Kështu që unë e shoh me vend të bëj një propozim që në pikën 5 të shtohet pikërisht edhe ky fakt, pra që një kopje e tabelës së rezultatit të grupit të numërimit të votave, e vulosur me vulën e KZAZ-së, afishohet nga sekretari i KZAZ-së në vendin e krijuar në VNV për këtë qëllim. Sipas përcaktimeve që ne kemi bërë edhe në vendimin e mëparshëm tonin, vendimi nr.3, datë 09.02.2021, neni 10, pika “d” e tij.

Znj. I.Nano: Pra, në aktin e miratuar më herët nga ne, është përcaktuar një vend ku duhet të afishohet tabela e rezultateve të GNV-së me vulën e KZAZ-së.

Z. D.Çaka: Atëherë unë doja ta citoja në nenin 10, pika “d” e tij, ne kemi përcaktuar pra, neni 10, që është dhe skema organizative, skema organizative e funksionimit të VNV-së do të jetë sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pika “d” e këtij neni thuhet: Vendi ku do të afishohen kopje të tabelës së rezultateve të qendrave të votimit të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së dhe kopje e tabelave përmbledhëse sipas rasteve mëposhtme.

Znj. I.Nano: Në rregull, kolegë atëherë, po zoti Çakaj!

Z. M.Çakaj: Për sa kohë e kemi në një akt pararendës të miratuar ta ngarkojmë dhe këtë akt?

Znj. I.Nano: Me sa po shoh aty është përcaktuar vendi, materialet, çfarë ka në vendin e numërimit të votave, kurse kjo është si një hap, si një veprim që duhet kryer. Kalojmë në votimin e propozimit, pra në pikën 5 të shtohet akti që një kopje e tabelës së rezultatit e vulosur me vulën, të GNV-së, e vulosur me vulën e KZAZ afishohet nga sekretari i KZAZ, në vendin e krijuar në VNV për këtë qëllim.

Kush është dakord me propozimin ju lutem?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 22, mbyllja e kutisë me fletët e votimit. Atëherë, këtu nuk besoj se ka nevojë që të ndërhyjmë pas atij propozimi që bëmë, sepse tek pika 1, fletët e votimit në zarfe të ndara sipas subjektit zgjedhor, ajo supozohet që ai zarfi që thamë është brenda subjektit zgjedhor, nuk e di nëse e vlerësoni që ka nevojë për të bërë ndërhyrje, jo? Atëherë nuk është se kemi të bëjmë me ndonjë propozim të ri, ne tashmë kemi miratuar në një nen paraardhës, një parashikim, një normë të re, kështu që po i kërkojmë administratës në këtë moment që në fjalinë e parë të pikës 1, pas nxjerrjes së rezultateve dhe plotësimit të tabelave të rezultateve, fletët e votimit futen në zarfe të ndara sipas subjekteve zgjedhore, referuar ose duke marrë parasysh dhe parashikimet e nenit përkatës, ku ne bëmë ndërhyrjen, pra ishte neni 18, pika 8, sepse në fakt ky është momenti që futen në zarfe dhe futen në kuti.

Z. M.Çakaj: Pra, atje është veprimi, ky është momenti...

Znj. I.Nano: dhe procesverbali që thamë do jetë gjithashtu pjesë e procesverbaleve që do të futen në zarfe. Gjithsesi kjo është një çështje që do ta vlerësojë Komisioneri në procesverbalin që do të miratojë. Atëherë nga administrata një kujtesë, në fakt në këtë projektvendim kemi disa modele, model KZAZ 29, model KZAZ 30. Unë mendoj që ta lëmë, modele të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe ta kemi parasysh, në të gjitha aty ku kemi të nominuara modelet, themi, model i miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kështu që a ta votojmë, apo thjesht të biem dakord? E votojmë që aty ku kemi në akt, gjithandej në akt, model, KZAZ me numër të caktuar, ta zëvendësojmë me shprehjen, modele të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. 1. Kemi dhe ndërhyrjen tjetër që thamë, referencën duhet ta kemi te

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

neni 18, pika 8, kështu që mbas fjalisë së parë dhe në pikën e dytë kemi, reflektimin e ndryshimeve të nenit 18 edhe tek 2-shi, ku bëhet fjalë për procesverbalet. Atëherë votojmë këto 3 propozime. 1. Përgjithësimin e modeleve, pra t'i lëmë me modele të miratuara nga Komisioneri.

Votojmë të parin, kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Dhe dy ndryshimet e tjera janë, një në pikën 1, një në pikën 2, referimi tek neni 18, pika 8 për zarfin dhe referimi në pikën 2, 18 pika 8 për procesverbalin. Kush është dakord, ju lutem kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në nenin 23, nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja në zgjedhjet për Kuvend. Ka ndonjë koment, ka ndonjë pyetje, ndonjë diskutim apo propozim konkret? Nëse jo, votojmë nenin 23 sipas përmbajtjes, po zoti Çakaj!

Z. M.Çakaj: Tani që po e shoh, kisha unë një propozim konkret. Në titullin e nenit 23, pasi titulli parashikohet, nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit nga KZAZ-ja në zgjedhjet për Kuvend. Në fakt ky është momenti që ne nxjerrin rezultatet vetëm për subjektet, ndërsa për zgjedhjet për Kuvendin është momenti përfundimtar ose riformulim vetëm për subjektet, sepse procesi përfundimtar është pasi nxjerr rezultatit e përgjithshëm, pra në nenin 25 vijues më pas, është nxjerrja e rezultatit për zgjedhjet për kandidatët e partive dhe koalicionet zgjedhore, dhe rezultatit e përgjithshëm... Kështu që me rastin konkret, korrektësisht do të ishte, të reflektohet në titull momenti procedural...

Z. Y.Merkaj: 25 e kemi shënuar ne për kandidatët.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Znj. I.Nano: Pra në titull, nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për subjektet zgjedhore. Në rregull, ka nevojë të reflektohet në tekstin e nenit?

Z. M.Çakaj: Në tekst është e reflektuar.

Znj. I.Nano: Kandidatët janë në fazën tjetër, këtu jemi vetëm te subjektet, nxjerrja e rezultatit, nxjerrja e tabelës përmbledhëse, shiko se në nenin 25 e kemi, nxjerrja e rezultatit për kandidatin, dhe pastaj 26 kemi nxjerrjen e tabelës përmbledhëse.

Z. M.Çakaj: Pra, në rastin konkret duke qenë se veprimi procedural është pasi kemi numëruar votat për subjektet zgjedhore, kemi bërë dhe ndarjet siç parashikon dhe Kodi Zgjedhor, siç parashikon dhe rrjedha normale e veprimeve, titulli i nenit konkret duhet të ishte: Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për subjektet zgjedhore për Kuvend.

Znj. I.Nano: Në rregull! Votojmë propozimin e zotit Çakaj për ndryshimin e titullit.

Atëherë kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 24, Numërimi i votave për kandidatët e listave shumëëmërore të partive politike dhe koalicioneve zgjedhore. Kemi ndonjë koment, ndonjë diskutim, propozim për shtesa apo ndryshime?

Atëherë, kalojmë në votimin e nenit 24, kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 25: Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët e partive politike dhe koalicioneve zgjedhore nga grupi i numërimit. Komente, propozime për shtesa apo ndryshime? Nga subjektet zgjedhore, deri tani nuk kemi patur ndonjë koment apo propozim. Kalojmë në votimin e nenit 25!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 26: Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja, për kandidatët në zgjedhjet për Kuvend.

Z. D. Çaka: Më falni kolegë, duke qenë se ke një nen më përpara ke afishimi, ne miratuam afishimin e tabelës për subjektet zgjedhore, ndërkohë këtu jemi tek tabela për kandidatët e listës shumemërore, besoj që duhet të shtohet edhe këtu i njëjti ndërhyrje siç bëmë edhe tek neni i mëparshëm.

Znj. I. Nano: Vetëm nenin ju lutem zoti Çaka, të ndërhyrjes së mëparshme, që ne ta votojmë dhe pastaj,

Z.D.Çaka: Atëherë ishte, në nenin 21, pika 5.

Znj. I.Nano: Atëherë votojmë propozimin e zotit Çaka, që të shtohet një paragraf, si neni 21 pika 5, të shtohet tek neni 26 pika 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Ju lutem gjatë zbardhjes të vendoset i njëjti paragraf me të njëjtin formulim, pra si për subjektet dhe për kandidatët të afishohet tabela e rezultateve. Kreu i fundit i këtij projektvendimi me 2 nene, neni 27 shfuqizim dhe neni 28, hyrja në fuqi dhe ankimi në fakt u relatua më herët nga sekretari i përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që në kushtet e reja kur ka ndryshuar Kodi Zgjedhor, jo pak sa i përket procesit të numërimit dhe të veprimtarisë së grupeve të numërimit dhe të KZAZ-së, lind nevoja e shfuqizimit të udhëzimit të mëparshëm të 2015. Atëherë votojmë nenin 27, shfuqizim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, të Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Të nderuar kolegë, kemi shqyrtuar dhe miratuar në parim dhe nen për nen projektvendimin për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, është momenti që ta votojmë në tërësi vendimin. Ju ftoj kolegë të votojmë vendimin në tërësi,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Me 5 vota pro miratohet projektvendimi!

Atëherë kjo pikë e rendit të ditës përfundoi, shqyrtimi dhe miratimi i aktit sikundër ishte vendosur në rend të ditës!

Vendimi nr.14

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



10.04.2021
Ora 12:45

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, E.Meta |

Parti Politike: LSI

Vëzhgues : OSBE/ODIHR

Znj. I. Nano: Tashmë 2 kolegë, zonja Vukaj dhe zoti Çakaj kanë kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës. Zonja Vukaj?

Znj. H.Vukaj: Faleminderit e nderuar zonja Nano! Më lejoni që, në vijim të shqetësimeve për vijuese që kam ngritur, vijoj me të njëjtin shqetësim edhe sot, ndaj e gjeta me vend që të marr fjalën dhe të ngre këtë çështje jashtë rendit të ditës, pasi është shumë delikate dhe në të njëjtën kohë bie ndesh me atë çfarë ne kemi miratuar më herët, po para se konkretisht të ekspozoj shqetësimin do të thosha ndërkohë ne përpiqemi të normojmë, përpiqemi të sjellim për terrenin dhe për këtë proces kaq të rëndësishëm zgjedhor një akt si ky sot, ku ne ruajtmë që të gjithë integritetin e përcjelljes siç duhet dhe me profesionalizëm të lartë të Kodit

Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

në këtë akt, po kështu kemi ruajtur integritetin dhe kemi ruajtur në të njëjtën kohë paritetin e palëve dhe në aktin e mëparshëm për veprimtaritë e ndaluara, që siç e dimë dhe siç e dini janë të pafundme bërjet publike dhe denoncimet publike të shkeljes haptazi dhe me një dinamizëm të pa shoq të këtij akti nga pushtetarët, funksionarët e pushtetit qendror por edhe funksionarët e pushtetit vendor, apo të institucioneve të tjera të pavarura si dhe enteve. Janë me të vërtetë shumë shqetësuese këto prishje mekanizmesh që na bëjnë mua sot, të reagoj e para dhe ta ndaj publikisht këtë shqetësim dhe për më tej do kërkoj dhe ose ndërhyrjen ose raportim nga një person i autorizuar, që kanë të bëjnë me denoncimet të cilat përkohshëm me punësime të përkohshme. Herën e kaluar, në mbledhjen para rendëse unë kërkova informacion nga Drejtoria e Thesarit dhe njëherësh nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore për punësimet progresive, muaj pas muaji që nga momenti kur ne kemi proklamuar aktin tonë për veprimtaritë e ndaluara. Shpresoj që ky informacion të mos vonojë sepse efekti ose jepet tani ose përtej zgjedhjeve nuk ka ç'na duhet, le të merren ogane të tjera. Qëllimi ynë është të parandalojmë sa të munemi, kështu që jo vetëm punësimet por kemi investime të pa shoq dhe të pa shembullta ndonjëherë, të elektorale, si asfalte elektorale pa procedura, lancime procesesh të tjera, prokurimesh e kështu me rradhë. Kemi shpërndarje ndihmash, parash, çertifikata pronësie natën dhe këto janë pa precedentë, në këmbim sigurisht të votave dhe këto janë denocuar në emisione të ndryshme investigative. Jo më larg se para 5 minutave përpara se të futenim në mbledhje, një kronikë në një nga televizionet bënte fjalë për një të arrestuar i cili në këmbim të një shume të madhe parash tentonte të shpërndante fletën e votimit e ngjashme me fletën tonë, për manipulime të mëtejshme apo veprime të cilat janë shumë delikate, në këtë moment dhe janë kriminale. Në këtë kuadër duke qenë që, nga subjekte të ndryshëm, nga individë të ndryshëm ka kallëzime, të cilat janë depozituar në Prokuroritë e Rretheve, në Prokurorinë e Tiranës, meqënëse është qarku më i madh dhe delikat, në SPAK, në këtë organizëm kaq të veçantë, ndaj të cilit ne

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

presim një rezultante për hir të qëllimit të krijimit të tij, kërkoj, bazuar në ligjin 101/2020, të datës 23.07.2020, i cili miratoi marrëveshjen politike të 5 Qershorit, kërkoj zoti Merkaj, që ti përcillet zotit Komisioner, t'a adresojë me shkresë kërkesën tonë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili duhet të na vijë menjëherë në një seancë dhe të na informojë urgjent mbi kallëzimet e bëra në degët e prokurorive në të gjithë rrethet si dhe në Tiranë. Kjo është e menjëhershme sepse ne duhet të marrim masat dhe të parandalojmë përpara se krimi zgjedhor të kaplojë të gjithë vendin. Kjo që po ndodh është shumë shumë e rrezikshme dhe kuptimi i tërë akteve tona e humbet vlerën e tij, nëqoftëse nuk ka reagim dhe nuk ka integracion mes organeve ligjzbatuese, parandaluese apo nuk ka fleksibilitet në zgjidhjen apo në procedimin e shpejtë të këtyre kallëzimeve. Prokurori mesa di, ka nxjerrë edhe një kallëzim numër 2, datë 31.03.2021, i cili në nenin 3 ka ndryshuar një pikë 7, ku autorizon detyrimin për Prokurorinë e Përgjithshme, të informimit të KQZ-së, në periudha të caktuara, pra menjëherë ai ka reaguuar por do të ishte e denjë dhe për momentin shumë me vlerë, ku ai të ishte në një seancë dëgjimore ku të na informonte konkretisht mbi kallëzimet dhe punën e tij në drejtim të përshpejtimit të procesit peritencial. Faleminderit të nderuar kolegë!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj, zoti Merkaj besoj mbajtet shënim kërkesën e zonjës Vukaj, për t'ja përcjellë Komisionerit?

Z. Y. Merkaj: Po patjetër, për t'ja përcjellë Komisionerit.

Znj. I. Nano: Faleminderit. Zoti Çakaj kishit dhe ju diçka jashtë rendit të ditës?

Z. M. Çakaj: Po e nderuar, faleminderit! Në fakt, ashtu siç kemi vijuar edhe në mbledhjet e kaluara, me denoncimet për avantazhe të padrejta elektorale, edhe unë në ditën e sotme në vijim edhe të koleges Vukaj, dua të bëjë një denoncim

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

konkret. Para 4 ditësh, jemi njohur siç rëndom po ndodh në këto vite, vetëm nëpërmjet faqeve të rrjeteve sociale on line, facebook, instagram, sepse nuk punojnë faqet zyrtare fatkeqësisht edhe pse është detyrim edhe nga Kodi Zgjedhor, jemi njohur se Këshilli Bashkiak, ka miratuar një vendim për përjashtimin nga pagesa e detyrimit të tarifës së zënies së hapësirës publike për periudhën prill - shtator 2021, për gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitete për bar, restorante dhe hotele, të klasifikuara si biznes i vogël, gjithashtu është vendosur dhe shtyrja e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për të gjitha subjektet deri në datë maj 20 maj 2021. Absolutisht që, me thelbin jemi dakord por fatkeqësisht dhe nëse nuk ka informacion juridik, mund të punësojë Bashkia Tiranë, mund të punësojë më pak fotografë dhe paparacë dhe mund të punësojë dhe më shumë juristë të lexojnë dhe Kodin Zgjedhor dhe vendimin numër 9, të miratuar nga Komisioni Rregullator, posaçërisht për mos marrjen e avantazheve të pa drejta dhe ta lexojnë në mënyrë integrale dhe të plotë edhe parashikimet e vendimit numër 9, për veprimtaritë e ndaluara por edhe parashikimet e nenit 91, pika 4 ku citohet; 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve, ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e aktive ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive, shpërblimeve etj, është e disata herë që posaçërisht nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës po bëhet veprimtari e ndaluar, kështu që në këtë kontekst unë do të ftoja edhe njëherë administratën dhe Krye Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, që të nisin hetimin kryesisht, meqë kemi të bëjmë me recidivizëm, nëse e gjykojmë të arsyeshme mund të depozitojmë edhe kallëzim penal. Faleminderit, kaq kisha!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.04.2021*

Znj. H.Vukaj: Edhe një shtesë të vogël, të lutem?

Znj. I. Nano: Po zonja Vukaj?

Znj. H.Vukaj: Ndoshta e zgjatëm, por është kaq e rëndësishme sa që nuk mund të ndalemi pa vënë theksin mbi çfarë propozoi zoti Çakaj, është shumë e rëndësishme, që zoti Komisioner në këtë rast duhet të reagojë, pasi jo vetëm e konsideroj sfidë ndaj aktit tonë, veprimtarinë e Kryetarit të Bashkisë, por absolutisht ka kaluar caqet e një shkeljeje të thjeshtë administrative dhe normalisht ka arritur në caqet e një shkeljeje të avancuar, asaj penale. Është absolutisht një ndërhyrje nga ana e tij totalisht në dëm të procesit zgjedhor, e bërë haptazi, e bërë në karshillëk dhe e bërë në dis favor të një pjese tjetër të popullatës, e cila ndoshta nuk gëzon privilegjet të jetë afër zotit Erion Veliaj, apo të përfitojë nga privilegjet e tij të momentit, joshëse apo në shkëmbim të diçkaje, dhe diçka tjetër, në momentin kritik në të cilën ndodhemi dhe në momentin e zhvleftësimit të këtij akti, pra në momentin e zhvleftësimit të aktit do të thotë që palët tashmë nuk janë të barabarta, i bëj thirrje çdo mekanizmi ndërkombëtar që ekziston në Republikën e Shqipërisë dhe që ka për objekt dhe qëllim mbajtjen shënim apo monitorimin dhe vëzhgimin të kësaj sjellje, do t'i lutesha, vëmendje të shtuar dhe të mbajnë shënim realisht, pasi kjo që po ndodh është e pa precedentë. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Faleminderit kolegë dhe pjesëmarrës, duke qenë që nuk kemi çështje të tjera për të shqyrtuar, e mbyllim, e deklarojmë mbledhjen të mbyllur. Ditën e mirë!

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*

